

PARALAJMËRIMI I  
BESIMTARËVE NGA  
KHAUARIXHËT BIDATÇI

---

SHEJH ABDULLAH EL BUHARI

**PARALAJMËRIMI I MUSLIMANËVE  
NGA KHAUARIXHËT BIDATÇI**

**SHEJH ABDULLAH EL BUHARI**

Titulli origjinal: تحذير المسلمين من الخوارج المحدثين

Tahdhirul muslimin minel khauarixhil muhdethijn

Titulli i plotë: Paralajmërimi i muslimanëve nga Khauarixhët bidatçi

Autor: Prof. Dr. Abdullah el Buhari

Përktheu: Idriz Manushi

Publikimi në web: [www.revistamedina.net](http://www.revistamedina.net)

© të gjitha të drejtat janë të rezervuara për përkthyesin

## بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

### HYTBEJA E PARË

Me të vërtetë falenderimet i takojnë Allahut, Atë falenderojmë dhe prej Tij ndihmë edhe falje kërkujmë. Kërkojmë mbrojtje tek Allahu nga e keqja e punëve dhe veteve tona. Kë e udhëzon Allahu nuk ka kush e humbë, dhe kë e humbë Allahu, nuk ka kush ta udhezojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut Një të Vetëm, pa i bërë shokë Atij, dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تُقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ

**“O besimtarë, frikësohuni Allahut me një frikë të vërtetë, dhe mos vdisni ndryshe vetëm se duke qenë muslimanë.”<sup>1</sup>**

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

---

<sup>1</sup> Ali Imran 102.

**“O njerëz, frikësohuni Zotit Tuaj, i Cili ju ka krijuar nga një palë e vetme, dhe krijoi prej saj bashkëshorten e tij, dhe nxorri prej tyre shumë burra e gra. Prandaj frikësohuni Allahut me emrin e të Cilit kërkon të drejta të ndërsjellta e mos i ndërprisni lidhjet farefisnore, me të vërtetë Allahu është kurdoherë vëzhgues mbi ju.”<sup>2</sup>**

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا، يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ  
وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا

**“O besimtarë, frikësohuni Allahut dhe flisni vetëm fjalë të sakta; ju përmirëson Allahu punët tuaja, ju falë juve gjynahet tuaja, dhe kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ai ka shpëtuar me një shpëtim të madh.”<sup>3</sup>**

Në vijim: me të vërtetë fjala më e mirë është Fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, punët më të keqija janë shpikjet në fe, çdo shpikje është bidat, çdo bidat është humbje, e çdo humbje të çon në Zjarr.

E më pas...

Dijeni ju bekoftë Allahu, se çdo kujt që i jepet mirësi, ai është i lakmuar, e sidomos o besimtarë, kur Allahu ju jep si mirësi qetësinë dhe mbrojtjen me “hijen” e Akides Sunije Selefije, me kujdesjen nga prijesi musliman, duke gjykuar me Sheriatin e Allahut të Lartësuar, i cili i kërkon Allahut ta ndihmojë në të (në

---

<sup>2</sup> En-Nisa 1.

<sup>3</sup> El Ahzab 70-71.

praktikimin e Sheriatit). Padyshim se kur gjendja është kjo, zemrat e të humburve, të bidatçive, të idhujtarëve dhe të shthururve janë të mbushura plot e përplot me inat dhe mlllef, e për këtë ne i themi të gjithë atyre (Fjalën e Allahut):

قُلْ مُوتُوا بِغَيْظِكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ

**“Vdisni ju me gjithë atë tërbimin tuaj, vërtetë Allahu është i Gjithëdituri për çka fshihet në gjokset tuaja.”<sup>4</sup>**

O besimtarë! Me të vërtetë bidati i Khauarixhëve është sprovë për këtë umet. Këta janë prej të parëve, ose janë bidati i parë.

Khauarixhët janë të parët që kanë përçarë muslimanët. Shejkhul Islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Dhe për këtë, të parët që kanë përçarë muslimanët prej bidatçive janë Khauarixhët el maarikun<sup>5</sup>.”<sup>6</sup>

Khauarixhët janë të parët që i kanë bërë muslimanët qafira për shkak të gjynaheve, ngase i kanë dalë atyre kundra në bidatin e tyre, andaj e kanë bërë të lejuar me këtë gjë gjakun e muslimanëve, nderin dhe pasurinë e tyre.

Shejkhul Islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Khauarixhët janë të parët që i kanë bërë qafira muslimanët me gjynahe, gjithashtu e bëjnë qafir këdo që i kundërshton ata në

---

<sup>4</sup> Ali Imra 119.

<sup>5</sup> Që dalin prej feje ashtu siç del shigjeta nga gjahu. (shp)

<sup>6</sup> Mexhmu’ul fetaua 3/349.

bidatin e tyre, ia kanë bërë hallall (të lejuar) vetes së tyre që t'i vrasin dhe t'ia marrin pasurinë muslimanëve.”<sup>7</sup>

Këta Khauarixhë – sipas asaj që përmendëm –, e bëjnë të lejuar daljen nga prijësi i muslimanëve.

Shejkhul Islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Khauarixhët dalin me shtatë kundrejt prijësit musliman, dhe i bëjnë qafira muslimanët me gjynahe.”<sup>8</sup>

Robër të Allahut! Ka ardhë në traditën e pastër dhe të saktë profetike, me fjalë nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, duke paralajmeruar dhe larguar prej Khauarixhëve. Ka urdhër nxitës për luftimin e tyre, ka shpërblim për atë që i lufton ata, apo ka shpërblim ai që vritet prej tyre. Gjithashtu ka ardhur se ata janë qentë e Xhehenemit, dhe se janë të vrarët më të këqinj nën këtë qiell.

Imami i Ehli Sunetit, imam Ahmed ibën Hanbeli, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Hadithi për Khauarixhët është i saktë nga dhjetë rrugë (transmetimi).”<sup>9</sup>

Prej haditheve, ju mbroftë Allahu, është ai i ardhur në dy Sahihët<sup>10</sup> nga Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem duke thënë:

---

<sup>7</sup> Mexhmu’ul fetaua 3/279.

<sup>8</sup> Mexhmu’ul fetaua 35/143.

<sup>9</sup> Es-Sunnetu lil Khal-lal 1/145.

<sup>10</sup> Bukhariu dhe Muslimi. (shp)

سيخرج في آخر الزمان قومٌ، أحداث الأسنان، سفهاء الأحلام، يقولون من خير قول البرية، يقرؤون القرآن لا يجاوز حناجرهم، يمرقون من الدين كما يمرق السهم من الرمية، فإذا لقيتموهم فاقتلوهم، فإن في قتلهم أجرًا لمن قتلهم يوم القيامة

**“Do të dalin në kohët e fundit disa njerëz të rinj dhe mendjelehtë, flasin me fjalët e më të mirit prej njerëzve, lexojnë Kuran dhe leximi nuk i kalon fytet e tyre, dalin prej feje ashtu siç del shigjeta prej gjahut. Nëse i takoni, atëherë vritini, sepse me vrasjen e tyre ka shperblim në Ditën e Gjykimit për atë që i vret.”**

Përsëri ka ardhur në dy Sahihët, nga Ebu Seid el Khudrij, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: “Erdhi një burrë me sy të futur brënda, me mollëza të dukshme, me ballë të gjerë, me mjekërr të dendur, me kokë të rruajtur dhe tha: O Muhamed, kije frikë Allahun! I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tha:

من يطع الله إذا عصيته ، أيامني الله على أهل الأرض فلا تأمنوني

**“Kush do t'i bindet Allahut në qoftë se unë e kundërshtoj?! Allahu më beson mbi njerëzit e tokës dhe ju nuk me besoni mua?!”** Një burrë i kërkoi ta lejonte ta vrasë atë – thotë transmetuesi: mendoj të jetë Khalid ibnul Uelid – dhe i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ndaloi që ta vrasë. Kur ai iku, i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha:



إن من ضئضىء هذا قوما يقرؤون القرآن لا يجاوز حناجرهم يمرقون من  
الدين مروق السهم من الرمية يقتلون أهل الإسلام، ويدعون أهل الأوثان  
لئن أنا أدركتهم لأقتلنهم قتل عاد

**“Nga pasardhësit e këtij, do të dalë një popull që e lexojnë Kuranin dhe nuk i kalon fytet e tyre, dalin nga feja siç del shigjeta prej gjahut. Ata vrasin muslimanët dhe i lejnë idhujtarët. Nëse unë i arrij, do t’i vras siç u vra populli i Adit.”**

Në Sahihun e Muslimit transmetohet nga Jusejr ibën Amër se ka thënë: pyeta Salih ibën Hanif: “A e ke dëgjuar të Dërguarin të përmendë Khauarixhët?” Tha: “E kam dëgjuar!” Bëri me shenjë nga lindja dhe tha: “Njerëz që lexojnë Kuranin dhe nuk jua kalon atyre fytet; dalin nga feja siç del shigjeta prej gjahut.”

Gjithashtu ka nxjerrë imam Tirmidhiu në librin e tij “El Xhamia”, po ashtu Ibnu Hibani dhe Ahmedi nga Ebu Galib se ka thënë: “Ebu Umameh shikoi koka të varura mbi shkallët e Damaskut – ato ishin kokat e Ezarikve prej Khauarixhëve, pasuesit e Nafiu ibën Ezrak – dhe Ebu Umameh tha: “Qentë e Xhehenemit, të vrarët më të fëlliqr nën këtë qiell.”

Thotë Ebu Galib: I thashë Ebu Umames: “A e ke dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem?”

Më tha: “N.q.s. nuk do ta dëgjoja një herë, apo dy herë, apo tre herë, apo kater herë – thotë Ebu Galib: dhe numëroi deri në shtatë herë – nuk do t’ju kisha treguar.”

Në Sahihun e Muslimit dhe tek Suneni i Ebu Daudit, në vazhdimin e hadithit të lartpërmendur të Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: “Po ta dinte ushtria që i ekzekuton ata (Khauarixhët), se çfarë shpërblimi ka treguar i Dërguari i tyre sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, nuk do të punonin më vepra të mira.” Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, tha: “Shenja për këtë, është se me ta gjendet një person me trup pa parakrahë, mbi krahun e tij ka një mollëz e vogël si majat e gjirit me disa qime të bardha”, dhe tha: “A do të ikni tek Muavija në Sham, e do t’i leni ata t’ju prijnë familjet dhe pasurinë tuaj?! Beto hem në Allah! Unë shpresoj që ata të jenë ai popull – d.m.th. që i përshkroi i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem – pasi ata kanë derdhur gjakun e muslimanëve, duke u strehuar mes njerëzve. Prandaj ecni (përparoni) me emrin e Allahut.”

Kur Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, gjeti tek populli që i kishte luftuar, burrin që ishte përshkruar në hadith, bëri Tekbir dhe ra në sexhde si falenderim për Allahun.

Ibën Kajimi ka thënë në librin “Zadul ma'ad”:

“Temë për: Sexhden e Ka'abit kur dëgjoi lajmin e atij që e përgëzoi. Ky është argument i qartë se ajo ishte zakoni i sahabëve – pra sexhdeja e falenderimit – ndaj një mirësie të re, apo për largimin e një të keqeje. Gjithashtu edhe Ebu Bekri ka bërë sexhde kur mori lajmin e vrasjes së Musejlime el Kedhabit (gënjeshtarit të madh), edhe Ali ibën Ebi Talib ka bërë sexhde, kur gjeti atë me kokë si mollëza e gjirit, të vrrarë midis Khauarixhëve.”<sup>11</sup>

---

<sup>11</sup> Zadul Ma'ad 3/511.

Ka nxjerrë imam Ebu Daudi në Sunenin e tij, po ashtu imam Ahmedi në Musnedin e tij dhe e ka saktësuar shejkh Albani Allahu e mëshiroftë, nga Ebu Seid el Khudrij dhe Enes ibën Malik, Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve, nga i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, se ka thënë duke përshkruar Khauarixhët:

هم شرُّ الخلقِ والخليقةِ طوبى لمن قتلهم وقتلوه يدعوونَ إلى كتابِ اللهِ وليسوا

منهُ في شيءٍ مَن قتلهم كانَ أولى باللهِ منهم قِيلَ: يا رسولَ اللهِ ما سِماهم؟

قَالَ: التَّحْلِيْقُ

**“Ata janë popull që lexojnë Kuran, por nuk jua kalon fytet, ata janë krijesat më të këqija dhe më të këqinjte për njerëzit. Lum për atë që i vret ata, apo vritet prej tyre; thërrasin për tek Libri i Allahut dhe vetë s'janë kurrkund me të. Kush i vret ata, ai është më i privileguari i njerëzve tek Allahu.”** Thanë: O i Dërguari i Allahut, cilat janë cilësitë e tyre dalluese? Tha: **“Rruajtja.”**

O ju besimtarë! Selefët tanë prej sahabëve dhe imamllarët pas tyre, i janë nënshtruar asaj që ka ardhur nga i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem lidhur me Khauarixhët. Ata kanë sqaruar dhe paralajmëruar prej tyre, i kanë bërë të qarta gabimet e tyre, i kanë refuzuar rrëshqitjet e tyre, janë angazhuar me luftimin e tyre.

Shejkhul Islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Kur u përhap në umet çështja e Khauarixhëve, sahabët folën për ta, transmetuan hadithet nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-

lem për ta, dhe çfarë ka në Kuran si kundërpërgjigje ndaj tyre, e prap u përhap bidati i tyre tek njerëzit e thjeshtë.”<sup>12</sup> D.m.th. që selefët i përhapën këto për të gjithë njerëzit, që ata të ruhen prej tyre.

Ka thënë përsëri, Allahu e mëshiroftë: “Dije se luftimi Khauarixhëve të Nahruanit, të cilët i vrau Ali ibën Ebi Talib, ishte si urdhër prej Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Aliu ishte i shpërblyer dhe i lëvdur për luftimin e tyre. Sahabët dhe imamllarët janë pajtuar për luftimin e tyre.”<sup>13</sup>

Ka thënë përsëri, Allahu e mëshiroftë: “Kur ata dolën në khilafetin e prijësit të besimtarëve Ali ibën Ebi Talib, Allahu qoftë i kënaqur me të, ata i luftoi Aliu dhe sahabët e të Dërguarit sal-lallahu alejhi ue sel-lem, me urdhërin dhe nxitjen e të Dërguarit për luftimin e tyre. Të gjithë imamllarët e Islamit janë pajtuar për luftimin e tyre.”<sup>14</sup>

Ka nxjerrë Abdullah ibën Ahmed në librin “Es-Sunneh”, një ether nga Nafi’ Meula Abdullah ibën Umer dhe etheri është i saktë: “Ibën Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, mendonte se luftimi i Harurijëve (Khauarixhëve) është e vertëtë dhe detyrë për të gjithë muslimanët.”

Imam Ibën Ebi Shejbe gjithashtu ka nxjerrë në “el Musannef”, po ashtu Abdullahu në “Es-Sunneh”, me zinxhir të saktë nga Ezrak ibën Kajs, se ka thënë: “Ishim në Ahuaz duke luftuar Khauarixhët, dhe kishim në mesin tonë Ebu Berzete el

---

<sup>12</sup> Mexhmu’ul fetaua 7/483-484.

<sup>13</sup> Xhamiul Mesail 6/267.

<sup>14</sup> Mexhmu’ul fetaua 3/382.

Eslemij – sahab i nderuar –, që erdhi në një lumë, mori abdes, u ngrit dhe u fal.”

Dijeni ju mbroftë Allahu, se Khauarixhët i bëjnë keq besimtarëve dhe i lejnë mosbesimtarët.

Ka thënë imam Bukhariu në Sahihun e tij, në temën: “Pendimi i atyre që lejnë fenë”, me nëntemë: “Vrasja e Khauarixhëve dhe të pafeve, pasi ia paraqesim atyre argumentin”, [ka përmendur]: “Ibën Umeri mendonte se ata ishin njerëzit më të keqinj, dhe ka thënë: “Ata kanë marrë prej ajeteve që kanë zbritur për mosbesimtarët, dhe i praktikuan ndaj besimtarëve.”

Po! Kjo kështu ka qenë edhe më përpara, edhe tani. Kështu bënin, kështu vendosnin dhe kështu diskutonin, sa ju mbushën zemrat e tyre me ëndje, siç thotë Allahu:

فَلَمَّا زَاغُوا أَزَاغَ اللَّهُ قُلُوبَهُمْ

**“Kur ata devijuan nga rruga e Allahut, Allahu ua largoi (dhe devijoi) zemrat nga rruga e drejtë.”<sup>15</sup>**

Shejkhul Islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Khauarixhët vrasin muslimanët dhe lejnë mosbesimtarët. Ata ndihmojnë mosbesimtarët në vrasjen e muslimanëve. Ata iu nënshtruan mosbesimtarëve, u bënë ndihmuesit dhe të poshtëruarit e tyre; kundërshtarë të besimtarëve dhe kryelartë ndaj tyre.”<sup>16</sup>

---

<sup>15</sup> Es-Saff: 5.

<sup>16</sup> Ed-Der'u 6/138-139.

Ue la haula ue la kuwete il-la bil-lah!<sup>17</sup>

Ka nxjerrë imam AbdurRezaku në tefsirin e tij dhe Abdullah ibën Ahmed në “Es-Sunneh” me zinxhir të pranueshëm, se Ibnul Keua – i cili ka qenë prej Khauarixhëve – e pyeti Ali ibën Ebi Talib për Fjalën e Allahut:

قُلْ هَلْ نُنَبِّئُكُمْ بِالْأَخْسَرِينَ أَعْمَالًا

**“Thuaj: do t’ju lajmërojmë për humbësit më të mëdhenj të veprave të tyre”<sup>18</sup>, çfarë është për qëllim me “humbësit më të mëdhenj”? Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, tha: “Aty hyjnë Ehlu Harura”, d.m.th. Khauarixhët, dhe në një transmetim tjetër: “Ti dhe shokët e tu.”**

Ka thënë imam Axhurri, Allahu e mëshiroftë, në “Esh-Sheriah”: “Dijetarët e mëparshëm dhe ata të tanishëm, nuk kanë kundërshtim se Khauarixhët janë popull i keq, kundërshtues të Allahut dhe të Dërguarit të Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, edhe nëse falen apo përkushtohen në adhurim, atyre nuk u bën dobi. Ata paraqiten sikur urdhërojnë për mirë dhe ndalojnë nga e keqja, por nuk u bën dobi, sepse ata janë popull që e shtrembërojnë Kuranin ashtu si e don ëndja e tyre, dhe ia imponojnë këtë muslimanëve. Allahu na ka paralajmëruar prej tyre, po ashtu dhe i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, e po ashtu katër Khalifët, sahabët dhe ata që i ndoqën. Khauarixhët janë të këqinjët, fëlliqësira dhe ndotësira. Kush është në rrugën e tyre prej Khauarixhëve, e trashëgojnë këtë rrugë, qofshin ata përpara, apo

---

<sup>17</sup> Nuk ka ndihmë dhe fuqi vetëm se prej Allahut. (shp)

<sup>18</sup> El Kehf: 103.

këta të tanishmit. Ata dalin ndaj prijesve (e thyejnë besën) dhe e bëjnë të lejuar vrasjen e muslimanëve.”

Po ashtu thotë: “Ata i ka luftuar Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, e Allahu i Lartësuar e nderoi me vrasjen e tyre. Ai ka lajmëruar nga i Dërguari sal-Allahu alejhi ue sel-lem për vlerën e atij që i vret ata, apo që vritet prej tyre, dhe bashkë me të morën pjesë edhe sahabët. Shpata e Aliut kundra Khauarixhëve, u bë shpatë e të vërtetës derisa të bëhet Kiameti.”

Allahu më begatofte mua dhe ju me Kuranin dhe Sunetin! Na bëftë dobi mua dhe ju me atë që përkujtojmë prej argumentave dhe urtesisë! Thashë atë që dëgjuat dhe i kërkoj falje Allahut për mua dhe për ju nga çdo gjynah; vërtetë Ai është Falësi, Mëshiruesi.

## HYTBEJA E DYTË

Falenderimi i takon Allahut, falenderimet e shumta, të mira dhe të begata janë për Atë. Lutjet për falje dhe për shpëtim të plotë janë për zotërinë e birit të Ademit, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, lutje të shumta për shpëtim deri në Ditën e Gjykimit.

E më pas:

O ju besimtarë – o ju mbroftë Allahu –, me të vërtetë medituesi në hadithet e të Dërguarit, në etheret e sahabëve dhe atyre që kanë ardhur nga imamët e Sunetit lidhur me cilësitë dhe përshkrimin e Khauarixhëve, i bëhen të qarta cilësitë e tyre. Këto cilësi gjenden tek të mëparshmit dhe tek të tanishmit, si bërja e grumbullimeve jashtë Sunetit dhe xhematit, jashtë rrugës së besimtarëve, të cilat kanë dalë nga grupe të ndryshme me petke të ndryshëme, por të gjitha grupe bidatçije: si xhemati Ikhuanol Muslimin, xhemati Tablig dhe kush i ndjek si Kutbijet dhe pjellat e tyre; edhe sikur të emërtohen këto organizime me emra si Al Kaeda, Xhebhету al Nusrah, apo duke u vetëquajtuar me shpifje, genjështër dhe trillim si shtet Islam në Irak dhe Sham, apo ISIS siç thonë ata; me qëllim që të hedhin poshtë ekzistencën e një shteti Islamik apo vendi Islam.

Siç ka dhënë fetva njëri prej tyre me injorancë dhe ëndje, duke i gjykuar të gjitha shtetet dhe vendet se janë mosbesimtare – ue la haula ue la kuwete il-la bil-lah –, për këtë arsye, ai ka dhënë fetva se është detyrë që të bëjmë hixhret tek ata; pra të gjithë muslimanët të shkojnë dhe të grumbullohen me njerëzit e ëndjeve dhe bidateve humbëse.



Sa çudi uAllahi! Prej injorancës së tyre të madhe dhe devijimit nga Suneti, e përgjithësuan gjykimin me kufër (mosbesim) gjithë shoqëritë dhe individët, me qeveritarë apo të qeverisur, me dijetarë, nxënës diturie apo masën e gjerë të njerëzve.

Kështu i trashëgojnë parimet e tyre të prishura, të ndërtuara mbi tekfir, mbi shpërthime dhe mashtrime, duke i akuzuar njerëzit e dijes dhe duke i bërë ata mosbesimtarë – Allahu na ruajtë – siç kanë bërë më përpara me sahabët e të Dërguarit sal-Allah u alejhi ue sel-lem, saqë e thyen besën e dy Khalifëve të drejtë; Uthmanit dhe Aliut, Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve, duke pasuar njëri-tjetrin në tekfir, në dalje nga Suneti dhe në shëmtimin e imazhit të Islamit të vërtetë dhe të dëlirë.

Pasha Allahun! Atyre u shkon për shtat fjala e shejkhul Islam Ibën Tejmijes, Allahu e mëshiroftë: “Khauarixhët bidatçinj, të cilët e thyen besën e Uthmanit dhe Aliut, vendosën mendjet dhe ëndjet e tyre si gjykues të Librit të Allahut, të Sunetit të Pejgamberit dhe historisë së Khalifëve të drejtë. Me këtë logjikë e bënë të lejuar fitnen, derdhjen e gjakut dhe të tjera veprime të ndaluara.”<sup>19</sup>

Gjithashtu ka thënë, Allahu e mëshiroftë: “Pretenduan se pasojnë të qartën e Kuranit, edhe pse Suneti i kundërshton. Khauarixhët janë të humbur në lidhje me kuptimin e Kuranit dhe të Sunetit gjithashtu.”<sup>20</sup>

---

<sup>19</sup> Xhamiul Mesail 6/391.

<sup>20</sup> Xhamiul Mesail 6/325

Po ashtu, ka thënë: “N.q.s. njihet (dhe dihet) origjina e bidatit, atëherë origjina e tyre është se i bëjnë mosbesimtarë gjynahqarët, besojnë se është gjynah ajo që nuk është gjynah, mendojnë se pasohet Kurani dhe jo Suneti që kundërshton Kurantin në aparencë të parë, edhe sikur (Suneti) të jetë Muteuatir<sup>21</sup>. Ata i bëjnë mosbesimtarë atë që i kundërshtojnë, e bëjnë të lejuar ndaj tij – si pasojë e kundërshtimit të tij – më shumë se çfarë lejojnë ndaj mosbesimtarëve në origjinë, siç ka thënë për ta i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

يقتلون أهل الإسلام ويدعون أهل الأوثان

**“Ata vrasin muslimanët dhe i lejnë idhujtarët.”** Për këtë, ata i bënë mosbesimtarë Uthmanin dhe Aliun bashkë me të afërmit e tyre, po ashtu i bënë mosbesimtarë pjesëtarët e Sifinit, e të tjera fjalë të poshtra si këto.”<sup>22</sup>

Pastaj dijeni ju mbroftë Allahu dhe jini të vetëdijshëm, se ky vend i begatë është synimi i të gjithëve<sup>23</sup>, në akiden e saj, në moralin e saj, në qetësinë e saj, në sigurinë e saj dhe në bindjen e popullit ndaj prijësit të saj në çdo gjë që është e pranuar. Po ashtu është e synuar në ekonominë e saj, në rehatinë e saj, në arsimin e saj, e më kryesorja në praktikimin e Sheriatit të Allahut, ku mund të themi së është e synuar në çdo gjë të saj.

Mundohen të prishurit, të humburit, mosbesimtarët, të pafetë, perëndimorët, bidatçitë dhe çdo kush tjetër që është si ata,

---

<sup>21</sup> E përhapur, e pranuar dhe e njohur. (shp)

<sup>22</sup> Mexhmu’ul Fetaua 3/395

<sup>23</sup> Pra, duan që të mos jetë. (shp)

kushdo që i ndihmon, që i bindet dhe që u përgjigjet atyre, që të prishin të mirat e lartpërmendura, duke përhapur rrëmuje dhe shkatërrim rreth akides së saktë dhe të kulluar selefije, rreth moralit të lartë dhe të pëlqyeshëm, rreth sigurisë së kudo ndodhur; i lavdëruar është Allahu për mirësitë e Tij.

Ata, ju mbroftë Allahu, kanë metoda të ndryshme dhe forma të shumta që i përdorin, nëpërmjet njerëzve të dobët dhe atyre të rënë në këtë fitne, apo nëpërmjet atyre që janë te pakujdesshëm, apo nëpërmjet atyre që merren me kontrata pune, apo nëpërmjet atyre që hyjnë për të ndotur këtë vend, apo nëpërmjet atyre që vijnë si vizitorë të saj, qofshin meshkuj apo femra.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَلَنْ تَرْضَىٰ عَنْكَ الْيَهُودُ وَلَا النَّصَارَىٰ حَتَّىٰ تَتَّبِعَ مِلَّتَهُمْ

**“Kurrë nuk do të jenë të kenaqur me ty o Muhamed, as çifutet dhe as të krishterët, derisa t’i ndjekesh ata (në fenë e tyre).”<sup>24</sup>**

Ajo që e keni parë edhe ju, është se Khauarixhët e rinj, pjesëtarë të Al Kaedas, përpiqen të frikësojnë dhe veprojnë gjëra të ndaluara, i kalojnë kufijtë e lejuar në këtë vend të sigurtë dhe në vende të tjera muslimane, duke vrarë njerëzit e rendit (policët) – muxhahidët e vërtetë n.q.s. punën e bëjnë për hirë të Allahut –. Ata (Khauarixhët) ndërmarrin vepra shkatërruese si: shpërthime, vrasje, bombardime, etj. Të gjitha këto, pasha Allahun, janë argument i qartë dhe tregues i madh për devijimin e tyre nga e

---

<sup>24</sup> El Bekare: 120.

vërteta dhe kërkimi i saj. Po të logjikonin, apo të kërkonin të ndihmonin të vërtetën, do të vepronin ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar në Kuran:

فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

**“Prandaj pyesni njerëzit e dijes në qoftë se nuk dini.”<sup>25</sup>**

Mirëpo, si t’i pyesin dijetarët, kur ata nuk i konsiderojnë ata si dijetarë të vërtetë?! Na mëshiro o Zoti ynë, na mëshiro!

Nga veprat e tyre të shëmtuara dhe të ulëta, si ajo që bënë disa të fëlliqur prej Khauarixhëve, kryengritësa të larguar nga Suneti, të nxitur nga mësuesi i humbjes, i tekfirit dhe shpërthimit, të cilët cënuan zonën kufitare të Uedias në rrethin e Sheruras, në këtë muaj të begatë të Ramazanit<sup>26</sup>, për të cilin Allahu thotë:

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَىٰ  
وَالْفُرْقَانِ

**“Muaji i Ramazanit në të cilin kemi zbritur Kuranin si udhëzues për njerëzit, si dallues i qartë midis të drejtës dhe të gabuarës.”<sup>27</sup>**

Gjithashtu shpërthimi që bënë në rrethin e Sheruras, duke vrarë dhe plagosur shumë prej njerëzve që ruajnë qetësinë, duke harruar ata Khauarixhë dënimin e dhembshëm që Allahu ka

---

<sup>25</sup> En-Nahl: 43.

<sup>26</sup> Muaji Ramazan 2014. (shp)

<sup>27</sup> El Bekare: 185.

premtuar për atë që vret një besimtar me qëllim, apo që vret një person që ka hyrë në atë vend me marrëveshje. Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَمَنْ يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُتَعَمِدًا فَجَزَاءُوهُ جَهَنَّمُ خَالِدًا فِيهَا وَغَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَلَعَنَهُ  
وَأَعَدَّ لَهُ عَذَابًا عَظِيمًا

**“E kush vret një besimtar me qëllim (vetëdije), shperblimi i tij është Xhehenemi, ku do qëndrojë aty përgjithmonë, zemërimi i Allahut dhe mallkimi i Tij është mbi të, dhe për të është përgatitur një dënim i madh.”<sup>28</sup>**

Allahu i Lartësuar ka thënë:

مَنْ أَجَلٍ ذَلِكَ كَتَبْنَا عَلَى بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنَّهُ مَنْ قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ  
فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا

**“Për shkak të kësaj, Ne urdhëruam për bijtë e Israilit që çdo kush që vriste dikë, jo për shpagim, por si krim në tokë, do të ishte sikur të ketë vrarë krejt njerëzimin. Nga ana tjetër, nëse dikush shpëton një jetë njeriu, do të ishte sikur të ketë shpëtuar jetën e të gjithë njerëzimit.”<sup>29</sup>**

Ka ardhur në Sahihun e Bukhariut, nga Abdullah ibën Amër ibnul A'as, nga i Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ue sel-lem se ka thënë:

---

<sup>28</sup> En-Nisa: 94.

<sup>29</sup> El Maide: 32.

الكبائر الإِشراك بالله وعقوق الوالدين وقتل النفس واليمين الغموس

**“Gjynahet e mëdha janë: t’i bësh shirk Allahut, mos respektimi i prindërve, të vrasësh të pafajshëm dhe betimi i rrejshëm.”**

Përsëri në Sahihun e Bukhariut, nga Abdullah ibën Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me ta, se ka thënë: “Me të vërtetë prej punëve shkatërruese që s’ka dalje po të biesh në të, është derdhja e gjakut të ndaluar pa shkakun e lejuar (padrejtësisht).”

Gjithashtu në Sahihun e Bukhariut, nga Abdullah ibën Amër, Allahu qoftë i kënaqur me ta, nga i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, se ka thënë:

من قتل معاهداً لم يرح رائحة الجنة، وإن ريحها يوجد من مسيرة أربعين عاماً

**“Kush vret një të strehuar (që i është dhënë besa)<sup>30</sup>, nuk e ndjen erën e Xhenetit edhe pse era e tij ndjehet dyzet vite larg.”**

Kjo në rastin e atij që strehohet tek ne o besimtarë, e si do jetë me muslimanin i cili e veçon Allahun në adhurim, falet dhe agjeron?!

Ka ardhur në dy Sahihët nga Abdullah ibën Mes’udi, se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

---

<sup>30</sup> Si p.sh. besa që i jep një shtet vizitorëve apo atyre që hyjnë. (shp)

لا يحل دم امرئ مسلم يشهد أن لا إله إلا الله ، وأني رسول الله ، إلا بإحدى  
ثلاث : النفس بالنفس ، و الشيب الزاني ، والتارك لدينه المفارق للجماعة

**“Nuk lejohet gjaku i muslimanit, i cili dëshmon se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut, vetëm se në tre raste: njeriu për njeriu, i martuari që bën imoralitet, ai që del nga feja dhe e braktis bashkësinë.”**

Hadithet për këtë temë janë të shumta, ju mbroftë Allahu. Andaj, ku shkojnë?! Si i përgjigjen gjithë këtyre argumenteve që janë në Kuran dhe Sunet?! Mjerë për ta dhe përsëri mjerë për ta, n.q.s. nuk pendohen tek Allahu përpara se t’ju vijë fundi, e mos të kenë mundësi të pendohen.

Me të vërtetë ajo që bëjnë burrat e sigurisë në këtë vend të begatë, duke ndaluar rreziqet, duke mbrojtur fenë, të mirat e popullit dhe të vendit, na e bën detyrë që të lutemi për ta dhe t’i lëvdojmë. Le të shpresojmë që të gjithë ata të jenë dëshmorë tek Allahu, me mirësinë dhe bujarinë e Tij, për qëndrimin e tyre përballë Khauarixhëve el maarikah<sup>31</sup>, përballë rreziqeve kërcënuese që mund të përfshijnë çdo kënd.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَاتَّقُوا فِتْنَةً لَا تُصِيبَنَّ الَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْكُمْ خَاصَّةً ۗ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ  
الْعِقَابِ

---

<sup>31</sup> Që dalin prej feje ashtu siç del shigjeta nga gjahu. (shp)

**“Dhe kini frikë (ruhuni) nga sprova e cila nuk dëmton vetëm ata që bëjnë keq, dhe dijeni se Allahu është i ashpër në ndëshkim.”<sup>32</sup>**

Le ta dinë burrat e sigurisë dhe kushdo që bën si ata, se janë në një llogore të madhe, në një xhihad të vazhdueshëm me të humburit el maarikun.

Imami sunetli Jahja ibën Jahja et-Tejmi ka thënë: “Mbrojtja e Sunetit është më e mirë sesa xhihadi.”<sup>33</sup>

Imami dhe shejkhul Islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Personi që kundërshton (dhe i kundërpërgjigjet) bidatçive, është muxhahid (luftëtar në rrugë të Allahut).”<sup>34</sup>

Le të shpresojnë që kohët e tyre të jenë për hirë të Allahut.

فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ

**“Se me vërtetë Allahu nuk ia humb kurrë shpërblimin e atyre që punojnë mirë.”<sup>35</sup>**

Le ta dinë se në ndalimin e tyre nga të bërit keq, në luftimin e tyre, në zbulimin e planeve dhe në kundërveprimin ndaj tyre, i bëjnë mirë gjithë umetit dhe janë këshillues për ta (që të ruhen prej tyre).

---

<sup>32</sup> El Enfal: 25

<sup>33</sup> Mexhmu’ul fetaua 4/13.

<sup>34</sup> Mexhmu’ul fetaua 4/13.

<sup>35</sup> Hud: 115.



E lus Allahun me emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta, që t'i ndihmojë ata kundër armikut të tyre dhe tonit, ta poshtërojë të kotën dhe pjesëtarët e saj, në çdo vend dhe në çdo kohë, t'i mëshirojë ata që kanë vdekur prej tyre dhe t'i pranojë si dëshmorë.

E lus Allahun ta ruajë vendin tonë, vendet e muslimanëve dhe Ehli Sunetin në çdo vend me ruajtjen e Tij; të gjithë kemi nevojë për mbrojtjen dhe kujdesjen e Tij.

Allahu e poshtëroftë dhe e shkatërroftë të kotën dhe njerëzit e saj në çdo vend, Ai është Dëgjuesi dhe Lutjepranuesi.

Salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin tonë Muhamed, familjen dhe gjithë shokët e tij.